KNF - WB WiB Faza II - AFK II

Lokacioni:
Kosovë

Projekti numër:
53822

Sektori i biznesit:
Institucione financiare

Lloji i njoftimi:
Privat

Kategoria mjedisore:
FI

Data e aprovimit:
28 qershor 2022

Statusi:
Në alokim

DPP i shpalosur:
30 qershor 2022

Sipas seksionit 1.4.2 (iii) të Direktivës për Qasjen në Informacion: "Për projektet e miratuara nga menaxhmenti i Bankës ku Bordi i Drejtorëve ka deleguar autoritetin për aprovim, DPP do të shpaloset në fillim të periudhës përkatëse të njoftimit për asnjë kundërshtim për një vend anëtar të Bankës në përputhje me nenin 13 (iii) të Marrëveshjes për Themelimin e BERZH-it."

Përshkrimi i projektit

Një hua senior e pasiguruar deri në 2 milionë euro që do të ofrohet në dy këste të barabarta në kuadër të Programit Gratë në Biznes në Ballkanin Perëndimor ("WB WiB") Faza II.

Objektivat e Projektit

Të ardhurat e investimit të Bankës do të përdoren për kreditimin e mëtutjeshëm për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme të pranueshme të udhëhequra nga gratë në Kosovë në përputhje me Deklaratën e Politikës.

Ndikimi i Tranzicionit

Rezultatet e ETI: 68

Projekti kontribuon në objektivat e Fazës II të WB WiB-së, duke mbështetur cilësitë e Ndikimit të Tranzicionit si **Gjithëpërfshirës** dhe **Konkurrues**:

Gjithëpërfshirës: Projekti do të kontribuojë në përfshirjen ekonomike të grave të rinj duke mbështetur qasjen e NMVM-ve të grave në financa dhe shërbime këshillimore për biznesin, duke demonstruar edhe argumente afariste për rritjen e shkallës së huadhënies për segmentin e NMVM-ve të drejtuara nga gratë.

Konkurrues: Ndikimi i tranzicionit pritet të rrjedhë nga zgjerimi i tregut në përputhje me Kornizën për Ndërmjetësues Financiarë të BERZH-it.

Informata për Klientin

AGJENCIONI PËR FINANCIM NË KOSOVË

Agjencioni për Financim në Kosovë ("AFK") është institucioni më i madh mikrofinanciar në Kosovë, i organizuar si organizatë joqeveritare ("OJQ"). Themelimi i Agjencionit u financua nga kontributet e marra përmes Mercy Corps, një OJQ me qendër në SHBA. Në veprim prej tetorit 2000, AFK-ja siguron qasje në financim për ndërmarrësit mikro dhe të vegjël, veçanërisht në zonat rurale.

Përmbledhja e Financimit të BERZH-it

2,000,000.00 EURO

Gjithsej Kosto të Projektit

2,000,000.00 EURO

Shtesë

Zbutja e Riskut: AFK-ja aktualisht mbështetet në huamarrjet me shumicë nga investitorët institucionalë dhe IFN-të. Edhe pse ka opsione të tjera më të lira të financimit nga këta investitorë që mund të jenë të qasshme, AFK-ja e vlerëson marrëdhënien afatgjatë me BERZH-in si financues; BERZH-i i ofron komfort klientit me përkushtimin e vet ndaj zhvillimit të mëtejshëm të praktikave të veta dhe gjithashtu pritet të nxisë besimin mes financuesve të tjerë të klientit bazuar në reputacionin e BERZH-it dhe njohuritë specifike për kontekstin.

Njohuritë, inovacioni dhe ndërtimi i kapaciteteve: Në kuadër të programit të Fazës II të WB WiB, BERZH-i ofron një paketë mbështetëse gjithëpërfshirëse që përfshin, krahas financimit, BT (Bashkëpunim Teknik) dhe Mbulimin e Riskut të Humbjes së Parë. Së bashku, këta komponentë pritet ta ngrenë kapacitetin e AFK-së që t'u shërbejë nevojave

të NMVM-ve të udhëhequra nga gratë, të përmirësojë mundësitë e vetë NMVM-ve të udhëhequra nga gratë (nëpërmjet mbështetjes me KBV (Këshillimi për Bizneset e Vogla)) dhe përfundimisht të kontribuojnë në zbutjen e hendekëve gjinorë në qasjen në financa dhe njohuritë në vend.

Përmbledhja Mjedisore dhe Sociale

I kategorizuar FI (ESP 2014). AFK-ja është klient ekzistues dhe ka demonstruar pajtueshmërinë me KP-të 2, 4 dhe 9 përmes Raportit të fundit Mjedisor dhe Social për vitin 2021. AFK-së do t'i kërkohet të vazhdojë të zbatojë Procedurat e Menaxhimit të Riskut Mjedisor dhe Social të BERZH-it për Huatë për Mikro, NVM dhe Korporata, si dhe KP-të e zbatueshme, dhe të paraqesë raporte vjetore të MS në Bankë. AFK-ja ka personelin e duhur dhe procedurat për menaxhim të riskut për të mbuluar kërkesat e linjave NMVM dhe Gratë në Biznes. AFK-së i kërkohet të zbatojë procesin e vet aktual për menaxhim të riskut MS dhe të sigurojë pajtueshmërinë e nën-projekteve me kërkesat kombëtare për MSHS. Me këtë projekt nuk lidhet asnjë Pjesë e TEGJ (Tranzicioni drejt Ekonomisë së Gjelbër)

Bashkëpunimi Teknik dhe Financimi me Grante

BT FI: Deri në 2 milionë euro në nivelin e programit për përfituesit në kuadër të Fazës II të WB WiB, duke u fokusuar në vlerësimin bazë, ndërtimin e kapaciteteve, zhvillimin e produktit, marketingun dhe mbështetjen për komunikim. Fondet për BT ofrohen nga Qeveria e Suedisë.

Këshillimi për BT për Biznese të Vogla: Deri në 3.5 milionë euro në nivel Programi për të mbështetur NMVM-të e udhëhequra nga gratë (përfshirë shërbimet këshilluese, trajnimin, mentorimin dhe mundësitë e rrjetëzimit).

Jo BT: Ndarja e riskut në formën e Mbulimit të Riskut të Humbjes së Parë ("MRHP") deri në 10% të Huasë, me tavan prej 70% për çdo nën-hua të vetme. Fondet jo-BT për MRHP sigurohen nga Fondi i Posaçëm i Aksionarëve të BERZH-it.

Informatat e Kontaktit të Kompanisë

Vahdet Anadolli
VAnadolli@afkonline.org
+383 39 424 242
www.afkonline.org
Agjencioni për Financim në Kosovë (AFK) Lidhja e Prizrenit Nr.1, Pejë, Republika e Kosovës

Përditësimi i fundit i DPP-së

30 qershor 2022

Të Kuptuarit e Tranzicionit

Informata të mëtejshme në lidhje me qasjen e BERZH-it për matjen e ndikimit të tranzicionit janë të disponueshme këtu.

Mundësitë për Biznes

Për mundësitë për biznes ose prokurimet, kontaktoni shoqërinë kliente.

Për mundësi biznesi me BERZH-in (jo lidhur me prokurimin) kontaktoni:

Tel: +44 20 7338 7168
Email: projectenquiries@ebrd.com

Për projektet e sektorit shtetëror, vizitoni Prokurimet e BERZH-it:

Tel: +44 20 7338 6794
Email: procurement@ebrd.com

Pyetje të përgjithshme

Pyetjet specifike mund të bëhen duke përdorur formularin e BERZH-it për pyetje.

Politika Mjedisore dhe Sociale (PMS)

Kjo PMS dhe Kërkesat e lidhura të Performancës (KP) përcaktojnë mënyrat në të cilat BERZH-i zbaton zotimin e vet për të promovuar "zhvillimin e shëndoshë mjedisor dhe të qëndrueshëm". PMS-ja dhe KP-të përfshijnë dispozita specifike për klientët që të respektojnë kërkesat e zbatueshme të ligjeve kombëtare për informim dhe konsultim publik, si dhe për të krijuar një mekanizëm për ankesa për të marrë dhe lehtësuar zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të palëve të interesit, në veçanti, në lidhje me performancën mjedisore dhe sociale të klientit dhe projektit. Në përpjesëtim me natyrën dhe shkallën e risqeve dhe ndikimeve mjedisore dhe sociale të një projekti, BERZH-i kërkon edhe që klientët e vet ta shpalosin informacionin, sipas rastit, në lidhje me risqet dhe ndikimet që rrjedhin nga projektet, ose të ndërmarrin konsultime domethënëse me palët e interesit dhe t'i marrin në konsideratë dhe t'u përgjigjen reagimeve të tyre.

Më shumë informata mbi praktikat e BERZH-it në këtë drejtim jepen në PMS.

Integriteti dhe Pajtueshmëria

Zyra e Zyrtarit Kryesor për Pajtueshmërisë (OCCO) të BERZH-it promovon qeverisjen e mirë dhe siguron që në të gjitha aktivitetet e Bankës të zbatohen standardet më të larta të integritetit në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare. Kujdesi i duhur për integritetin kryhet për të gjithë klientët e Bankës për të siguruar që projektet të mos

paraqesin risqe të papranueshme për integritetin ose reputacionin e Bankës. Banka beson se identifikimi dhe zgjidhja e çështjeve në fazat e miratimit të vlerësimit të projektit, është mjeti më efektiv për të garantuar integritetin e transaksioneve të Bankës. OCCO luan një rol kyç në këto përpjekje mbrojtëse ,dhe gjithashtu ndihmon në monitorimin e risqeve të integritetit në projektet pas investimit.

OCCO është gjithashtu përgjegjës për hetimin e akuzave për mashtrim, korrupsion dhe sjellje të pahijshme në projektet e financuara nga BERZH-i. Çdokush, si brenda ose jashtë Bankës, që dyshon për mashtrim ose korrupsion, duhet t'i paraqesë një raport me shkrim Zyrtarit Kryesor për Pajtueshmërinë me e-mail në compliance@ebrd.com. Të gjitha çështjet e raportuara do të trajtohen nga OCCO për përcjellje. Të gjitha raportet, përfshirë ato anonime, do të shqyrtohen. Raportet mund të bëhen në çdo gjuhë të Bankës ose të vendeve ku operon Banka. Informacioni i dhënë duhet të jepet në mirëbesim.

Politika për Qasje në Informacion (PQI)

PQI-ja përcakton mënyrën se si BERZH-i e shpalos informacionin dhe konsultohet me palët e veta të interesit për të promovuar vetëdijesim dhe të kuptuar më të mirë të strategjive, politikave dhe operacioneve të veta, pas hyrjes në fuqi më 1 janar 2020. Ju lutemi vizitoni faqen e Politikës për Qasje në Informacion për të kuptuar se çfarë informacioni disponohet nga ueb faqja e BERZH-it.

Kërkesat specifike për informacion mund të bëhen duke përdorur formularin e BERZH-it për pyetje.

Mekanizmi i Pavarur për Llogaridhënie të Projektit (MPLLP)

Nëse përpjekjet për adresim të shqetësimeve mjedisore, sociale ose publike me Klientin ose Bankën janë të pasuksesshme (p.sh. përmes mekanizmit të ankesave në nivel të projektit të Klientit ose përmes angazhimit të drejtpërdrejtë me menaxhmentin e Bankës), individët dhe organizatat mund të kërkojnë t'i drejtojnë shqetësimet e tyre nëpërmjet Mekanizmit të Pavarur të BERZH-it për Llogaridhënie të Projektit (MPLLP).

MPLLP-ja i shqyrton në mënyrë të pavarur çështjet e Projektit që besohet se kanë shkaktuar (ose ka gjasa të shkaktojnë) dëme. Qëllimi i Mekanizmit është: të mbështesë dialogun ndërmjet palëve të interesit të Projektit për t'i zgjidhur çështjet mjedisore, sociale dhe publike; të përcaktohet nëse Banka është në pajtueshmëri me Politikën e vet Mjedisore dhe Sociale ose dispozitat specifike për projektin të Politikës së vet për Qasje në Informacion; dhe aty ku është e aplikueshme, të adresojë çdo papajtueshmëri ekzistuese me këto politika, duke parandaluar papajtueshmëritë e ardhshme nga ana e Bankës.

Ju lutemi vizitoni ueb faqen e Mekanizmit të Pavarur për Llogaridhënie të Projektit për të mësuar më shumë rreth MPLLP-së dhe mandatit të vet; si të paraqisni një kërkesë për

shqyrtim; ose kontaktoni MPLLP-në përmes adresës e-mail ipam@ebrd.com për të marrë udhëzime dhe më shumë informacion mbi MPLLP-në dhe mënyrën e paraqitjes së një kërkese.